REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE TIRANË

NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE

Për angazhimin e 1 (një) Këshilltari / Eksperti të Jashtëm në Administrim Publik

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë (DRTK Tiranë) shpall thirrjen për shprehje interesi për lidhjen e një kontrate shërbimi (këshilltar/ekspert i jashtëm) për mbështetjen e proceseve administrative dhe financiare të biletarisë në sitet e trashëgimisë kulturore.

1. Përshkrimi i Detyrave dhe Përgjegjësive:

Asiston Sektorin e Financës në administrimin, verifikimin dhe rakordimin periodik të biletave tëshitura (manuale dhe elektronike) në monumentet e kulturës (Mozaiku i Tiranës dhe Kalaja e Bashtovës).

Kontrollon zbatimin e tarifave zyrtare, kategorive me çmim të reduktuar dhe hyrjeve pa pagesë sipas Urdhrit nr. 715/2019, i ndryshuar.

Përgatit raportet statistikore dhe financiare të fluksit të vizitorëve dhe arkëtimeve.

Ndihmon në hartimin e akteve administrative, korrespondencës zyrtare dhe arkivimin e dokumentacionit financiar të biletarisë.

2. Kriteret e Kualifikimit:

Të ketë përfunduar arsimin e lartë (minimumi Bachelor / Master) në Administrim Publik (ose shkenca administrative/ekonomike të lidhura me të).

Të ketë eksperienc në punë min 1 vit.

Të ketë aftësi të mira organizative, analitike dhe njohuri të legjislacionit për administratën publike dhe menaxhimin financiar.

Të ketë njohuri shumë të mira të paketës Microsoft Office (veçanërisht Excel dhe Word).

Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional dhe të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

3. Dokumentacioni i Kërkuar:

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a- Jetëshkrimi i aplikantit;
b- Fotokopje të letërnjoftimit(ID);
c- Fotokopje të diplomës;
d- Fotokopje të listës së notave;
e- Fotokopje të librezës ë punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
h- Çertifikata kualifikimi;
i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

4. Mënyra dhe Afati i Aplikimit:

Dokumentacioni duhet të dorëzohet fizikisht pranë protokollit të DRTK Tiranë (Adresa: Rr. "Naim Frashëri", Godina nr. 1, Mozaiku i Tiranës) ose në rrugë elektronike në adresën info@drtktirane.gov.al, brenda datës 26.11.2026, ora 16:00.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda 3 (tre) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit, Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Tiranë, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe do të njoftojë nëpërmjet postës elektronike kandidatët të kualifikuar, të cilët do të njoftohen për datën dhe orën për intervistë.